## **SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA**

## **Neni 36**

### **Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

#### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Paga e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

#### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktojnë jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcaktojnë Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39                    PAGESA PAS SHKËPUTJES SË KONTRATËS**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40                    Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41                    Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

### **Neni 42                    Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### **Neni 43                    Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimin.



### PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante].*

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës       |           | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|-------------------------------------------|-----------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Përshkrimi i nenit                        | Neni. Nr. |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha              | 2.1       | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
|                                           | 2.2       | Gjuha e përdorur do të jetë gjuhët në përdorim zyrtarë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Siguria e ekzekutimit                     | 10.1      | Shume e sigurisë së ekzekutimit është NA                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit | 11.2      | Shuma minimale e sigurimit do të jetë: <ul style="list-style-type: none"> <li>(a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i>;</li> <li>(b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i>;</li> <li>(c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i>;</li> <li>(d) dëmtim personal ose vdekje: <ul style="list-style-type: none"> <li>(i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i></li> <li>(ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i></li> </ul> </li> </ul> |
|                                           | 12.1      | Planin për Menaxhimin e Kontratës.<br>Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 2 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|                                           | 12.2      | Periudha për Programin e azhurnuar është 2 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Fillimi i punëve                          | 17.1      | Data e fillimit do të jetë : Dy ditë pas nënshkrimit të kontratës, në konsultim me menaxherin e projektit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
|                                           | 17.2      | Përfundimi i punëve bëhet sipas planit të menaxhimit të kontratës 45 ditë kalendarike, ose deri me date:20.11.2023.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Dëmet e likuiduara                        | 19.1      | Norma e dëmeve të likuiduara është 0.10% e Çmimit final të Kontratës në ditë.<br><br>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|                                           | 20.1      | Një regjistër i punës do të mbahet nga ana e kontraktuesit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Inspektimi dhe testimi                    | 22.1      | Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së punëve do të bëhet në momentin e dorëzimit që janë lëndë e kësaj kontrate, nga Komisioni i Pranimit të punëve – shërbimeve, i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues.<br><br>Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i punëve-shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Komisionit të                                                                                                                                                                  |

|                                                    |      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|----------------------------------------------------|------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                    |      | <p>Pranimi të punëve- shërbimeve të Autoritetit Kontraktues.</p> <p><b>Menagjer i projektit nga AK është: Xhybëhar Taipi</b></p> <p><b>Menagjer mbikqyrës i kontrates nga AK është: Bean Haxhiasani</b></p> <p><b>Menagjer i projektit nga OE është: Muhamed Meleqi</b></p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| Pagesa                                             |      | Sipas Raportit të prezantuar – dorëzuar nga Menaxheri i Projektit- situacioneve të aprovuara nga ana e Organit mbikëqyrës, kurse pjesa tjetër e pagesës do të realizohet pas përfundimit të punimeve të përcjellura me raport nga ana e menaxherit të kontrates dhe raportit nga ana e komisionit të pranimi teknik të projektit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Parapagimi                                         | 26.1 | Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagesë paraprake.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Mbajtja e Parasë                                   | 27.1 | Shuma e parave të mbajtura është: E vlerës së kontratës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Shkaqet për kompensim                              | 30.1 | Data e posedimit të vend punimit do të jetë [shëno numrin] ditë pas nënshkrimit të kontratës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Përgjegjësi mbi Defektet                           | 34.5 | <p>Periudha garantuese e defekteve është : 12 muaj nga data e pranimi teknik të përkohshëm.</p> <p>Dokumenti Polisa e sigurimit të kualiteti e lëshuar nga një Bank apo kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës 10 % vlerën e përgjithshme të kontratës, me afat validiteti për prej 12 muaj nga data e pranimi teknik të përkohshëm.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Pagesa pas shkëputjes së kontratës                 | 39.1 | Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve               | 42.2 | Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore | 43.1 | <p>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunalit të Përhershëm të Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p> |



|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |                |        |             |              |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|--------|-------------|--------------|
| 3.1.3                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | Furnizimi dhe shtrirja e Rërës 0-1mm, trashësi 10cm për shtatin nën gyp me planifikim 1.3cm, dhe 15 mbi gyp për mbulimin dhe mbrojtjen e gypit, sipas vërejtjeve dhe përshkrimeve teknike paraprake të specifikuar për pummet tokësore. Gjatë vendosjes së rërës të aplikohet gjanometria të për aktuar në bazë të rregullave dhe standardeve për aplikimin të materialeve ndërtimore në vepër. Ngjeshja sipas normave DIN, DPr 10 <sup>1</sup> % Llog. m <sup>3</sup><br><b>VËREJTJE:</b> Punimet do të kryhen me makineri aty ku ka mundësi të shkoj makineria pjesa tjetër me dorë për shkak se zona e punimeve zhvillohet në terene të ashpra, të thepisura me lartësi 1590.24m, është e pa mundur që të transportohen të dërgohen makineritë e rënda për hapjen edhe gërmin e kanaleve, kaptazhës në burime, si dhe drenazhimin përreth kaptazhës |                |        |             |              |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Rrë (0-1) mm                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | m <sup>3</sup> | 88.21  | 4.00 €      | 353.25 €     |
| 3.1.6                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | Largimin e ujërave nëntokësore me pomë të cilët shfaqen gjatë gërminit të kanalit, të cilët pengoj ecurin e punës në instalimin e rrjetit të ujësjellësit. Duke marrë parasysh që një pjesë e ujësjellësit kalon në zonën në afërsi të prrockës dhe lëshesave të rrugës gjatë ekzekutimit të projektit mund ballafaqohemi me sasi shumë të madhe të ujit. Llog. me orë/punë me aprovimin e organit mbikqytres.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | orë/punë       | 10     | 10.00 €     | 100.00 €     |
| 3.1.7                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | Angazhimi i pompës për largimin e ujërave nëntokësore                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                |        |             |              |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Vendosja e trakës mbrojtëse detektuese me gjerësi 3 cm përgjatë gjitha trasesë së rrjetit të ujësjellësit, për ta identifikuar zonën se ku ndodhet gypat pas mbulimit të kanalit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | m'             | 353.28 | 0.10 €      | 35.33 €      |
| 3.1.8                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | Vendosja e trakës mbrojtëse sinjalizuese me gjerësi 3 cm përgjatë gjitha trasesë së rrjetit të ujësjellësit, për ta identifikuar zonën se ku ndodhet gypat pas mbulimit të kanalit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | m'             | 353.28 | 0.10 €      | 35.33 €      |
| 3.1.9                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | Mbushja dhe mbulimi i kanalit pas instalimit të rrjetit ujësjellësit me sasi të dheut të përzgjedhur pa gurë me trashësi sipas skicave dhe detaleve të percaktuara në projekt për secilen pusete /stacionazh. pasaj vendoset pjesa tjetër e dheut deri në mbushje përfundimtare të terenit dhe këtimi në gjendje të mëparshme, dheu i tepër largohet në deponim më të afërt të caktuar nga organi mbikqytres. Në qmim llogaritet mbushja dhe mbulimi i kanalit me dorë duke angazhuar makinerinë dhe fuqin punëtore                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | m <sup>3</sup> | 88.32  | 2.00 €      | 176.64 €     |
| Gjithsej: Punët tokësore                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |                |        |             | 2,862.62 €   |
| 4                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Punët montuese (Fitingjet)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | Njësia         | Sasia  | Çmimi njësi | Çmimi i tërë |
| Pjesët montuese të vendosjes dhe instalimit të gypit shpërndarës për rritjen e kapaciteteve të ujit në fshatin Krusheve- K.K Dragash si dhe të fitingjeve prej kaptazhës deri në rezervuarin ekzistues duhet montuar dhe instaluar në koordinim me Ndërmarrjen për shërbime Publike të ujësjellësit në Komunën e Dragash (Hidroregjionit Jugorë), si dhe në përputhje me projektin, detaleve dhe përshkrimeve teknike, në përputhjen me normativa ndërtimore në fuqi si dhe standardet ISO 9001/2008 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |                |        |             |              |
